



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 5.

Prishtinë, më 19.01.2015 në ora 19:40.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqiu, Xhavit Haliti, Luljeta Veselaj –Gutaj, Rustem Mustafa, Kujtim Paçaku, Arben Gashi, Valdete Bajrami, Rustem Mustafa dhe Slllobodan Petroviç.

Munguan: Blerim Shala, Vjosa Osmani dhe Ilir Deda

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqia– kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurit e tyre, me raportin me amendamentet e Komisionit funksional**

Kryetarja: pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës hapi mbledhjen , ajo tha se për shqyrtim e kemi projektligjin me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim ekonomik,infrastrukturë,tregti dhe industri,raporti përmban vetëm dy amendamente dhe një amendament është bërë në Ligjin bazik, hapi debatin lidhur me at se a ka pas të drejt komisioni të bëjë amendament në Ligjin bazik.

Arben Gashi: tha ne si Komision kemi kompetencë ti shqyrtojmë amendamentet nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, Komisioni për Legjislacion duhet ta vlerësoj se a ka pas shkelje në këtë rast.

Edhe anëtarët tjerë prezent u pajtuan me vlerësimin e parafolësit se Komisioni për Integritet Evropian shqyrton projektligjet dhe amendamentet e komisionit funksional vetëm nga aspekti i përafrit me Acquis Communitare.

Kryetarja pas diskutimeve dhe pas votimit nxori këtë:

Përfundim

Me 6 vota pro dhe dy kundër, Projektligji Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurit e tyre, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Mbledhja përfundoi në orën 20:10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj.Teuta Sahatqia
